

Course Name : E Drejte Financiare							
Course Code	Course Type	Regular Semester	Lecture (hours/week)	Seminar (hours/week)	Lab. (hours/week)	Credits	ECTS
LAW 221	N/A	Fall	3.00	1.00	0.00	2.50	4.00
Lecturer		Enkelejda Koka, PhD					
Assistant							
Course language		Albanian					
Course level		Program i Integruar					
Description		Lënda e Drejta Financiare studion veprimtarinë financiare të shtetit dhe personave të tjerë juridikë, mekanizmat e mbledhjes dhe shpenzimit të mjeteve financiare, si dhe harmonizimin dhe planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve në kuadër të ekonomisë financiare që kryhen nga ana e institucioneve të financave publike. Kjo lëndë do të shqyrtojë aspektet ligjore të financave, ajo do të përshkruajë parimet bazë ligjore dhe parakushtet institucionale të financave dhe tregjet financiare. Kjo lëndë për studentët ofron njohuri juridiko-financiare shumë të rëndësishme mbi institucionet kryesore të financave publike përmes njohjes me teorinë mbi institucionet financiare si dhe praktikën e funksionimit të institucioneve financiare. Lënda do të studiojë tre çështje kryesore; si, sa dhe prej kujt duhet të mblidhen mjetet; ndarja e mjeteve midis subjekteve të ndryshëm; shpenzimi i mjeteve, për realizimin më të mirë të detyrave të shtetit dhe institucioneve juridiko-publike; cilat janë efektet e mbledhjes, ndarjes dhe shpenzimit nga shteti.					
Objectives		Njohuri te pergjitheshme per te Drejten financiare. Pervetesimi i koncepteve baze juridike ne lidhje me te drejten financiare. Marrredhenia Juridike e se drejtes Financiare dhe objekti i saj. Njohuri te pergjitheshme per te Drejten financiare. Pervetesimi i koncepteve baze juridike ne lidhje me te drejten financiare. Marrredhenia Juridike e se drejtes Financiare dhe objekti i saj					
Core Concepts		1. Customs 2. Tax 3. Public Loan 4. Budgetary expenditure 5. State Budget					
Course Outline							
Week	Topic						
1	Hyrje - Shkenca Financiare dhe e Drejta Finaciare Tema bën një prezantim të përgjithshëm të lëndës dhe trajton kuptimin e shkencës financiare dhe së drejtës financiare. Lidhja e ngushtë që ekziston mes të dyjave, por edhe diferencat që kanë me njëra-tjetrën do të jenë objekt studimi. Vecanërisht do të përcaktohet roli i së drejtës financiare në rregullimin e marrëdhënieve financiaro-juridike që krijohen gjatë mbledhjes, ndarjes dhe shpenzimit të mjeteve me të cilat plotësohen nevojat mbarëshoqërore. (Fq.12-39)						
2	Kuptimi i përgjithshëm i nevojave publike dhe klasifikimi i tyre Tema sqaron definicionin e nevojave publike, kuptimin e tyre, llojet dhe ndarjen që iu bëhet. Nevojat publike përbëjnë një ndër shkaqet themelore të rregullimit të marrëdhënieve financiaro-juridike përmes së drejtës financiare dhe një nga shkaqet themelore të ekzistencës së instrumenteve financiare të tilla si tatime, taksa, dogana etj. Identifikimi i saktë i llojeve të nevojave publike që justifikojnë nevojën për mbledhjen e mjeteve monetare përbën objektin kryesor të studimit gjatë zhvillimit të temës. (Fq.40-68)						

3	Të hyrat publike në teorinë dhe praktikën financiare si dhe sistemi dhe politika e formimit të të hyrave publike Tema trajton në mënyrë teorike të hyrat publike si dhe sistemin dhe politikën e formimit të tyre. Plotësimi i nevojave shtetërore e atyre shoqërore nga ana e shtetit në bazë të kompetencave të tij realizohet pikërisht me anë të mjeteve financiare të njohura si të hyra publike. Gjatë analizës do të bëhet edhe klasifikimi i të hyrave publike në të hyra burimore dhe të prejardhura; të hyra juridiko-publike dhe juridiko-private; të hyra të rregullta dhe jo të rregullta; të hyra nga personat fizikë dhe të hyra nga personat juridikë; të hyra të kthyeshme dhe të hyra të pakthyeshme; të hyra të destinuara dhe të hyra të padestinuara etj. Përveç trajtimit teorik, do të bëhet edhe një trajtim i disa rasteve të praktikës financiare për të ilustruar konceptet e shpjeguara. (Fq.69-83)
4	Tatimet: Qëllimi, Elementet, parimet dhe efektet Tema merr në shqyrtim tatimet, instrumentet themelore e kryesore financiare të mbledhjes së të hyrave, me të cilat shteti mbulon shpenzimet e veta me qëllim plotësimin e nevojave mbarëshoqërore. Përcaktimi i elementeve përbërëse, parimeve, karakteristikave, efekteve, qëllimeve dhe klasifikimi i tyre në varësi të kriterëve të përcaktuara përbën objektin kryesor të studimit. Qëllimet fiskale, qëllimet ekonomike dhe qëllimet sociale të tatimeve do të sqarohen në mënyrë të detajuar. Gjithashtu identifikimi i karakteristikave të tatimeve (të hyra derivative të shtetit, të detyrueshme, mbledhen në interesin publik, nuk kanë kundërshtpërbllim të drejtpërdrejtë etj) shërben për vecimin dhe diferencimin e tyre me forma të tjera të të hyrave publike. Tema gjithashtu do të fokusohet në klasifikimin e tatimit në tatime proporcionale dhe progresive, të rregullta dhe jo të rregullta, qendrore dhe lokale, me qëllim kuptimin e saktë të tatimeve si instrument themelor financiar. (Fq.84-103)
5	Kuptimi, rëndësia dhe përkufizimi i taksave dhe kontributeve Tema trajton një tjetër instrument të rëndësishëm për plotësimin e nevojave mbarëshoqërore sic janë taksat. Identifikimi i karakteristikave të taksave, përkufizimi që ligji iu bën, rëndësia që ato paraqesin për buxhetin e shtetit, dallimet që kanë me tatimet dhe forma të tjera të të hyrave publike janë në fokus të kësaj teme. Gjithashtu do të bëhet klasifikimi i taksave dhe kriteret e përcaktuara për këtë qëllim. Në shqyrtim do të jenë edhe kontributet, duke përcaktuar definicionin, llojet dhe karakteristikat e tjera të përcaktuara në legjislacion. (Fq.104-145)
6	Legjislacioni tatimor në Republikën e Shqipërisë Kjo temë trajton kuadrin ligjor rregullues në fushën e tatimeve dhe taksave, duke u fokusuar vecanërisht në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të këtij ligji do të shpjegohet si rregullohen procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë. Ligji, i cili është i zbatueshëm për tatimpaguesit, administratën tatimore, agjentët tatimorë; cdo person tjetër të përcaktuar nga legjislacioni tatimor, do të jetë objekti kryesor i analizës në këtë temë. (Fq.145-178)
7	Tatimet e Dyfishta dhe e Drejta Tatimore Ndërkombëtare Tema merr në shqyrtim parashikimet dhe rregullat ndërkombëtare në fushën e tatimeve, marrëveshjet ndërkombëtare që realizohen mes shteteve me qëllim lehtësimin e procedurave fiskale për subjektet që iu nënshtrohen atyre dhe rritjen e efektivitetit të mbledhjes së tyre nga ana e shtetit. Me rëndësi e drejta ndërkombëtare tatimore shfaqet në kuadër të eliminimit të tatimeve të dyfishta, duke përcaktuar procedurën dhe mënyrën sesi vepron shteti, me qëllim që subjekti të mos tatohet në mënyrë të dyfishtë për të njëjtën të ardhur apo fitim të realizuar. (Fq.179-196)
8	Provimi gjysmë final
9	Doganat, Sistemi Doganor Tema merr në shqyrtim doganat si një lloj i vecantë i tatimeve që paguhen në momentin e kalimit të një malli të caktuar përtej kufirit doganor. Tema analizon karakteristikat e doganave dhe klasifikimin e tyre në varësi të kriterëve të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: drejtimin e ecurisë(lëvizjes) së mallit, qëllimin e aplikimit të doganave, mënyrën e nxjerrjes së dispozitave doganore, lartësinë e ngarkimit doganor. Gjithashtu do të merret në shqyrtim legjislacioni doganor në Republikën e Shqipërisë dhe parashikimet kryesore për rregullimin e doganave. (Fq.197-225)
10	Analizë e çështjeve ligjore mbi funksionimin e doganave Kjo temë analizon çështje ligjore që lidhen me funksionimin e doganave. Legjislacioni doganor në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga Kodi Doganor, legjislacioni doganor ndërkombëtar lidhur me konventat në të cilat aderohet RSH dhe aktet nënligjore në zbatim të Kodit. Objekt studimi do të jenë vecanërisht regjimet e ndryshme doganore dhe problematikat në nivel teorik e praktik të lidhura me to. Regjim doganor do të thotë: vënia në qarkullim të lirë; tranziti; magazinimi doganor; përpunimi aktiv; përpunimi nën kontrollin doganor; lejimi i përkohshëm; përpunimi pasiv; eksportimi. Gjithashtu, analiza do të zgjerohet me shkeljet doganore të parashikuara në Kodin Doganor, të tilla si kundërvajtjet administrative doganore dhe kontrabanda. (Fq.226-253)

11	Taksat Kjo temë trajton taksat dhe parashikimet ligjore lidhur me to në Republikën e Shqipërisë. Taksat në Republikën e Shqipërisë ndahen në taksa kombëtare dhe taksa vendore. Taksat kombëtare caktohen nga pushteti qendror, mblihen nga pushteti qendror dhe derdhen në favor të buxhetit të shtetit. Taksat vendore caktohen nga pushteti vendor, mblihen nga pushteti vendor dhe derdhen në favor të buxhetit vendor të njësisë përkatëse. Në fokus të kësaj teme do të jetë vecanërisht ligji nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” , i cili përcakton llojet e taksave kombëtare që aplikohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nivelin e tyre, si dhe procedurat për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në buxhetin e shtetit, si dhe ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i cili përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore dhe mbledhjen e administrimin e tyre. (Fq.254-283)
12	Huaja Publike: Kuptimi dhe Zhvillimi Kjo temë definon huatë publike, shtetërore si kontrata, në bazë të të cilave, huadhënësi (personi fizik ose juridik) i jep huamarrësit (shtetit) një sasi të hollash ose sendesh, duke përcaktuar detyrimin e këtij të fundit t`i kthejë këto të holla ose sende në një afat të përcaktuar, së bashku me interesin. Përveçse kuptimit dhe përkufizimit, tema analizon në mënyrë të hollësishme përparësitë dhe mangësitë e huave publike, si dhe një studentët me klasifikimin e tyre në hua të brendshme dhe të jashtme, hua vullnetare dhe të detyrueshme, hua afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, hua kombëtare dhe lokale. Raste praktike të marrjes së huasë nga shteti shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar do të jenë gjithashtu pjesë e trajtimit gjatë zhvillimit të temës. (Fq.284-307)
13	Shpenzimet Publike Tema merr në shqyrtim dhe analizon shpenzimet publike në bazë të interpretimit doktrinal dhe legjislaionit në fuqi. Shpenzimet publike kryhen për të plotësuar nevojat publike (shtetërore, shoqërore). Përmes tyre shteti realizon detyrat, që i janë ngarkuar me kushtetutë apo ligje. Gjatë temës do të studiohet klasifikimi i shpenzimeve publike në shpenzime të rregullta dhe jo të rregullta, shpenzime investuese dhe transferuese, shpenzime personale dhe materiale, shpenzime të organeve qendrore dhe lokale. Gjithashtu do të studiohet përbërja e strukturës së shpenzimeve publike në përgjithësi dhe përmbajtja e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. (Fq.308-330)
14	Buxheti i Shtetit, kuptimi, e drejta, aprovimi dhe realizimi; parimet buxhetore; procedura buxhetore Tema merr në analizë parashikimet ligjore lidhur me Buxhetin e Shtetit dhe parashikimet kushtetuese për shkak të rëndësisë që paraqet. Gjithashtu, studentët do të njihen me parimet kryesore që duhet te ndiqen në hartimin dhe miratimin e buxhetit të shtetit dhe elementët përbërës të tij. Procedura buxhetore e përcaktuar në ligj me të gjithë komponentët e saj do të jetë në fokus të kësaj teme. (Fq.331-362)
15	review
16	Final Exam

Prerequisites		The student must attend the course at a minimum rate of 75%.
Literature		• 1. Genta Bungo, Shkenca mbi financat dhe e Drejta Financiare (botimi i dytë, ARSA 2009) • 2. Ligj Nr. 8438, Datë 28.12.1998 Për Tatimin Mbi të Ardhurat i ndryshuar • 3. Ligj Nr. 92/2014 Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar në Republikën E Shqipërisë • 4. Ligj Nr.9975, Datë 28.7.2008 Për Taksat Kombëtare i ndryshuar • 5. Ligj Nr. 102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë
References		• 1. Joseph J. Cordes, Robert D. Ebel and Jane G. Gravelle, eds., The Encyclopedia of 5 Taxation and Tax Policy, (Second Edition, The Urban Institute Press and the National Tax Association, 2005) • 2. Jonathan Gruber, Public Finance and Public Policy (Second Edition, Ëorth Publishers, 2007). • 3. Ligj Nr. 135/2015, Për Qendrën Kombëtare të Biznesit • 4. Ligj Nr. 66/2015, datë 14.07.2015, Për faljen e gjobave për mospagimin në afat të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga subjektet juridike dhe fizike • 5. Ligj Nr.9920, datë 19.05.2008, Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar • 6. Ligj Nr.10 418, datë 21.04.2011, Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor, i ndryshuar
Course Outcome		
1	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mundën të përshkruajnë dhe të diskutojnë për rëndësinë e ligjit financiar për krijimin dhe zhvillimin e tregjeve të forta financiare.	
2	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mundën të analizojnë kuadrin institucional që është i nevojshëm për ofrimin e kredisë dhe funksionimin e tregjeve financiare.	
3	Studentët do të mundën të shpjegojnë dhe të diskutojnë në mënyrë kritike për komponentët themelore ligjore të sistemit financiar.	
4	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mundën të identifikojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike rrezikun sistematik në tregun financiar hasur nga autoriteti financiar	

Course Evaluation			
In-term Studies	Quantity	Percentage	
Midterms	1	40	
Quizzes	0	0	
Projects	0	0	
Term Projects	0	0	
Laboratory	0	0	
Class Participation	1	10	
Total in-term evaluation percent			50
Final exam percent			50
Total			100
ECTS Workload (Based on Student Workload)			
Activities	Quantity	Duration (hours)	Total (hours)
Course duration (Including the exam week: 16x Total hours of the course)	16	4	64
Study hours outside the classroom (Preparation, Practice, etc.)	14	2	28
Duties	0	0	0
Midterms	1	0	0
Final Exam	1	2	2
Other	0	0	0
Total Work Load			94
Total Work Load / 25 (hours)			3.76
ECTS			4.00